

Kushtet e Përgjithshme për Sigurimin e Jetës - DL011008

Neni 1 - Dispozitat e Përgjithshme

1. Kushtet e Përgjithshme për Sigurimin e Jetës, në vazhdim Kushtet e Përgjithshme, janë pjesë përbërëse të kontratës për sigurimin e jetës.
2. Domethënia e disa fjalëve:
 - a. "Siguruesi" është kompania e sigurimit të jetës "Illyria Life" me të cilën kontraktohet sigurimi i jetës.
 - b. "Kontraktuesi i Sigurimit" është personi i cili me Siguruesin kontraktin sigurimin e jetës.
 - c. "Personi i Siguruar" është person fizik, jeta e të cilit është subjekt i sigurimit.
 - d. "Përfituesi" është personi të cilit i paguhet shuma e siguruar, në bazë të kontratës për sigurimin e jetës, me rastin e ndodhjes së rastit të siguruar.
3. Me kontratën për sigurimin e jetës Kontraktuesi i Sigurimit obligohet të paguaj preminë, dhe Siguruesi obligohet që me ndodhjen se rastit të siguruar, t'i paguaj Përfituesit shumën e siguruar, në bazë të kontratës për sigurimin e jetës.
4. Sigurimi i jetës sipas këtyre Kushteve të Përgjithshme mund të kontraktohet me ose pa kontrollim mjekësor.
5. Në kuadër të sigurimit të jetës mund të kontraktohet edhe Sigurimi Shtesë nga Aksidentet Personale.
6. Sipas këtyre Kushteve të Përgjithshme mund të sigurohen personat e shëndoshë nga moshë 14 deri në 65 vjeç, ashtu që moshë e Personit të Siguruar të mos i tejkaloj 70 vjeç në momentin e përfundimit të kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit. Për sigurimin e personave të tjerë përdoren Kushtet e Veçanta për Sigurimin e Rreziqeve të Zmadhuara.

Neni 2 – Oferta

1. Oferta paraqet propozim me shkrim për kontraktimin e sigurimit të jetës dhe përmban elemente të rëndësishme të kontratës, si dhe pyetjet mbi rrethanat në bazë të cilave Siguruesi vlerëson rrezikun për marrjen në sigurim.
2. Oferta paraqet obligim për Siguruesin, pas një periudhe prej 8 ditësh nga dita kur Oferta është pranuar nga Siguruesi. Nëse ekziston nevoja për kontrollim mjekësor, kjo periudhë shtyhet deri 30 ditë. Nëse Siguruesi nuk e

refuzon ofertën ose nuk ka kërkuar informata shtesë, konsiderohet se e ka pranuar ofertën dhe se kontrata është zyrtarizuar në ditën kur oferta ka arritur te Siguruesi.

3. Nëse në periudhën nga dërgimi i Ofertës deri te zyrtarizimi i kontratës për sigurimin e jetës vjen deri te ndryshimi i gjendjes shëndetësore të Personit të Siguruar, Kontraktuesi i Sigurimit, obligohet që menjëherë pas kuptimit të këtij fakti, ta njoftoj me shkrim Siguruesin. Në atë rast afatet nga pika 2. e këtij neni fillojnë përsëri pasi njoftimi ka arritur te Siguruesi.
4. Oferta është pjesë përbërëse e kontratës së sigurimit të jetës dhe për zyrtarizimin e kësaj kontrate mjafton që të dyja palët ta nënshkruajnë atë. Nëse Kontraktuesi i Sigurimit dhe Personi i Siguruar nuk janë person i njëjtë, për plotfuqinë e kontratës nevojitet edhe nënshkrimi i Personit të Siguruar.
5. Siguruesi rezervon të drejtën për ta refuzuar Ofertën për sigurim duke mos i përmendur fare arsyet për këtë veprim. Oferta së bashku me dokumentet e bashkangjitura nuk i kthehet ofertuesit.

Neni 3 – Polica

1. Polica e sigurimit të jetës lëshohet nga Siguruesi në një ekzemplar në bazë të shënimeve nga Oferta.
2. Në policë ceken të dhënat për Siguruesin, Personin e Siguruar, Kontraktuesin e Sigurimit, rastet e siguruara, fillimi dhe kohëzgjatja e sigurimit, shuma e siguruar, premia, mënyra e pagesës së premisë, Përfituesin për të gjitha rastet e siguruara, data e lëshimit të policës dhe nënshkrimi i autorizuar i Siguruesit.
3. Nëse të dhënat në policë dallojnë nga të dhënat në Ofertë, dhe deklaratat tjera me shkrim nga Kontraktuesi i Sigurimit, Kontraktuesi i Sigurimit mund të dorëzojë vërejtje me shkrim për ndryshime në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të policës. Nëse nuk ka vërejtje, pas kësaj periudhe vlejné të dhënat në policë.
4. Pjesë përbërëse e kontratës për sigurimin e jetës janë: Oferta, Kushtet e Përgjithshme, kushtet tjera të cekura në policë, tabelat për vlerat e kapitalizuara dhe riblerëse (vetëm te rastet ku, sipas kushteve, mundësohet kapitalizimi apo riblerja).

Neni 4 - Fillimi dhe Përfundimi i Obligimeve të Siguruesit

1. Fillimi i kontratës për sigurimin e jetës, është ora 00.00 e datës e cila shënohet në policë si fillimi i sigurimit, dhe skadimi në ora 00.00 e datës që shënohet në policë si përfundim i sigurimit.
2. Obligimet e Siguruesit fillojnë në ora 00.00 e datës e cila shënohet në policë si fillimi i sigurimit me kusht që deri në atë kohë është paguar premia . Nëse premia nuk është paguar deri në datën e cila shënohet në policë si fillimi i sigurimit, obligimet e Siguruesit fillojnë në orën 00.00 të ditës së ardhshme kur premia të jetë paguar.
3. Konsiderohet se obligimi i arritur për pagesë i premisë të sigurimit është paguar edhe atëherë kur Kontraktuesi i Sigurimit, respektivisht Personi i Siguruar, ka dhënë deklaratë me shkrim në bazë të së cilës pagesa e premisë do të realizohet me anë të ndalesave nga paga e tij, apo i ka dhënë bankës një urdhërpagesë afatgjate për pagesën e premisë nga llogaria e tij bankare.
4. Obligimet e Siguruesit përfundojnë me përmbushjen e obligimeve të tij gjatë dhe pas skadimit të kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit.

Neni 5 – Premia dhe Shuma e Siguruar

1. Lartësinë e premisë dhe shumës së siguruar e kontraktjnë Siguruesi dhe Kontraktuesi i Sigurimit, në bazë të sistemit tarifor, bazuar në: gjininë e Personit të Siguruar, moshën që Personi i Siguruar ka kur fillon sigurimi dhe kohëzgjatjen e kontraktuar të sigurimit. Moshë kur Personi i Siguruar kontraktin sigurimin paraqet ndryshimin në mes të vitit kalendarik të fillimit të sigurimit dhe vitit të lindjes së Personit të Siguruar.
2. Premia e cila duhet të paguhet për rreziqet e zmadhuara përcaktohet me Kushtet e Veçanta për Sigurimin e Rreziqeve të Zmadhuara të cilat aplikohen nga Siguruesi për çdo rast konkret.
3. Sigurimi mund të kontraktohet vetëm në valutën EURO.

Neni 6 - Pagesa e Premisë

1. Kontraktuesi i Sigurimit ka për obligim të paguaj preminë e sigurimit sipas afateve të kontraktuara, dhe Siguruesi të pranojë

preminë prej çdo personi i cili ka interes që ai të jetë paguar.

2. Premia parapaguhet sipas afateve të kontraktuara.
3. Premia paguhet çdo muaj. Premia mund të parapaguhet edhe përnjëherë, për një vit, çdo gjysmë viti, çdo tremujor, me zbritje.
4. Nëse ndodh vdekja e të Personit të Siguruar dhe sipas marrëveshjes premia është kontraktuar të paguhet çdo muaj, premia duhet të paguhet deri në fund të muajit në të cilin ka ndodhur vdekja. Nëse premia nuk ka qenë e paguar në atë shumë, pagesa e shumës së siguruar zvogëlohet për atë shumë e cila është e barabartë me preminë e pa paguar. Nëse premia është paguar edhe për muajt pas vdekjes, ndryshimi së bashku me shumën e siguruar bashkërisht i kthehet Përfituesit.
5. Nëse është kontraktuar pagesa e premisë në baza vjetore, gjysmë-vjetore apo tre-mujore, atëherë në rast të vdekjes parapagimi i premisë nuk kthehet, nëse është llogaritur zbritja për atë mënyrë pagese.
6. Nëse është kontraktuar pagesa e premisë të përnjëhershëm në rast të vdekjes premia nuk rikalkulohet në momentin e vdekjes dhe ndryshimi nuk kthehet për arsye se për pagesë të premisë të përnjëhershëm aplikohet tarifa e veçantë.
7. Premia paguhet përmes bankave të licencuara, apo arkave të Siguruesit.
8. Nëse premia paguhet përmes bankës konsiderohet se ajo i është paguar Siguruesit në orën 24.00 të ditës kur në bankë është vërtetuar pagesa.
9. Nëse ofertuesi gjatë dorëzimit të ofertës ka paguar një apo më shumë këste të premisë , pagesat pranohen si premi të paguara nëse kontrata për sigurim është zyrtarizuar, në të kundërtën i kthehet në shumën e plotë.

Neni 7 - Pasojat e Mospagesës së Premisë

1. Nëse Kontraktuesi i Sigurimit nuk paguan preminë sipas afateve të kontraktuara, Siguruesi ka obligim që Kontraktuesin e Sigurimit, me shkrim, ta ftojë që të kryen pagesën.
2. Nëse Kontraktuesi i Sigurimit në vërejtjen e Siguruesit, e cila duhet të dorëzohet me letër përmes postës, nuk e paguan preminë brenda afatit, i cili nuk mund të jetë më i shkurt se një muaj, duke llogaritur datën e dorëzimit të letrës, dhe nëse nuk e kryen këtë pagesë ndonjë person tjetër i interesuar, Siguruesi mundet që të:

- a. ndërpresë kontratën e sigurimit, në rast se premia është paguar për më pak se 2 vite, te sigurimet me kohëzgjatje të kontraktuar deri në 15 vite, respektivisht 3 vite te sigurimet me kohëzgjatje të kontraktuar prej 15 e më shumë viteve. Obligimet e Siguruesit në atë rast rregullohen sipas Nenit 21 të këtyre kushteve.
 - b. zvogëlon shumën e siguruar në vlerën e saj të kapitalizuar, nëse premia është paguar për së paku 2 vite te sigurimet me kohëzgjatje të kontraktuar deri në 15 vjet, respektivisht 3 vite te sigurimet me kohëzgjatje të kontraktuar prej 15 e më shumë viteve. Në këtë rast sigurimi vazhdon me shumën e siguruar të zvogëluar, pa nevoja për pagesë të mëtutjeshme të premisë .
3. Nëse ndodh rasti i siguruar gjatë periudhës së pritjes së pagesave të vonuara, Siguruesi ka për obligim që Përfituesit të sigurimit ti paguaj shumën e siguruar e cila zvogëlohet për shumën e premisë së papaguar.
 4. Nëse rasti i siguruar ndodh gjatë procedurës së ndërprerjes së kontratës apo zvogëlimit të shumës së siguruar (kapitalizimi), konsiderohet se shuma e siguruar është zvogëluar, respektivisht kontrata është ndërprerë, sipas pikës 2. të këtij neni.

Neni 8 - Obligimet e Kontraktuesit të Sigurimit

1. Kontraktuesi i Sigurimit ka obligim që me rastin e kontraktimit të sigurimit të jetës, Siguruesit ti deklarojë të gjitha rrethanat e rëndësishme për vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të njohura për të, apo të cilat nuk kanë mundur të mbeten të panjohura për të.
2. Rrethanat me rëndësi për vlerësimet e rrezikut janë përgjigjet në pyetjet e shkruara në Ofertë.
3. Nëse Kontraktuesi i Sigurimit me qëllim ka dhënë informata të pasakta, apo me qëllim ka heshtur ndonjë rrethanë të rëndësishme të asaj natyre që po të ishte e njohur për Siguruesin nuk do të kishte zyrtarizuar kontratën për sigurim, Siguruesi rezervon të drejtën që ta ndërpresë kontratën.
4. Në rast të ndërprerjes së kontratës për shkak të arsyeve të cekura në pikën 3. të këtij neni, Siguruesi e mban preminë e paguar dhe ka të drejtë të kërkojë pagesë të premisë së sigurimit për periudhën e sigurimit deri në shkëputjen e kontratës.
5. Nëse Kontraktuesi i Sigurimit pa qëllim ka

dhënë përgjigje të pasakta në pyetjet nga Oferta apo e ka lëshuar rastin të japë njoftim shtesë, Siguruesi mundet që brenda muajit nga kuptimi i pasaktësive apo njoftimit jo të plotë, sipas zgjedhjes së tij, të ndërpresë kontratën apo të propozoj rritjen e premisë në harmonizim me madhësinë e rrezikut, në përputhshmëri me Kushtet e Veçanta për Sigurimin e Rreziqeve të Zmadhuara. Kontrata në atë rast ndërpritet me kalimin e 14 ditëve nga dita kur Siguruesi deklaratën e tij për ndërprerje ia ka komunikuar Kontraktuesit të Sigurimit. Nëse Kontraktuesi i Sigurimit nuk e pranon propozimin e Siguruesit për rritje të premisë , ndërprerja hyn në fuqi në afat prej 14 ditëve nga dita kur Kontraktuesi i Sigurimit e ka pranuar njoftimin. Në rast të shkëputjes së kontratës, Siguruesi ka për obligim ta kthejë rezervën matematikore të mbledhur.

6. Pavarësisht nga pika 5., Siguruesi, në rast se Kontraktuesi i Sigurimit pa qëllim ka dhënë përgjigje të pasakta në pyetjet në ofertë apo nuk ka dhënë njoftim shtesë, nuk ka të drejtë në ndërprerje apo ndryshim të kontratës nëse nga fillimi i kontratës kanë kaluar më shumë se 2 vite.
7. Nëse rasti i siguruar ka ndodhur para konstatimit të pasaktësisë apo të dhënat jo të plota në ofertë, apo pas asaj, por para shkëputjes së kontratës, respektivisht para arritjes së marrëveshjes për rritje të premisë , shuma e siguruar zvogëlohet në harmonizim me preminë që do të duhet të paguhej bazuar në rrezikun e vërtetë.

Neni 9 - Riaktivizimi i Kontratës së Sigurimit

1. Kontrata për sigurimin e jetës, e cila ofron kompensim në rast të mbijetimit, e cila në bazë të pikës 2. neni 7., është ndërprerë apo i është zvogëluar shuma e siguruar, mund të riaktivizohet në bazë të kërkesës me shkrim nga ana e Kontraktuesit.
2. Kontrata për sigurimin e jetës mund të riaktivizohet vetëm një herë gjatë kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit.
3. Kërkesa për riaktivizimin e sigurimit mund të parashtrohet nga Kontraktuesi i Sigurimit më së voni në afat prej një viti nga dita e parë pas përfundimit të periudhës për të cilën është paguar premia e fundit.
4. Siguruesi obligohet që të vendos për riaktivizim të kontratës së sigurimit në afat prej tetë ditësh, nga dita e pranimit të kërkesës me

kusht që premia deri në atë ditë është paguar dhe se gjendja shëndetësore e të sigurvearit është e përshtatshme për marrje në sigurim.

5. Përgjegjësia e Sigurvearit me riaktivizimin e kontratës së sigurimit fillon në orën 00.00 në ditën kur me shkrim e ka konfirmuar pranimin e kërkesës për riaktivizim të kontratës për sigurim.
6. Me rastin e riaktivizimit të sigurimit, Sigurveari mund të kërkojë kontrollim mjekësor, si dëshmi se nuk ka ardhur deri te ndryshimi në gjendjen shëndetësore të Personit të Sigurvearit.
7. Nëse Personi i Sigurvearit në afat prej një viti pas riaktivizimit të sigurimit bënë vetëvrasje, Sigurveari i paguan shumën e barabartë me rezervën matematikore të mbledhur deri në atë ditë Përfituesit të sigurimit.
8. Nëse Personi i Sigurvearit brenda periudhës prej një viti pas riaktivizimit të sigurimit vdes nga sëmundja të cilën e ka pasur me rastin e dorëzimit të kërkesës për riaktivizim, e të cilën e ka heshtur në kërkesën për riaktivizim, Sigurveari paguan shumën e sigurvearit të zvogëluar në harmonizim me preminë që do të duhet të paguhej bazuar në rrezikun e vërtetë, vetëm nëse premia para riaktivizimit të sigurimit ka qenë i paguar për së paku dy vite.

Neni 10 - Deklarimi i Pasaktë i Moshës së të Sigurvearit

1. Nëse me rastin e kontraktimit të sigurimit të jetës është bërë deklarimi i pasaktë i moshës së Personit të Sigurvearit, atëherë:
 - a. nëse moshja e vërtetë e Personit të Sigurvearit tejkalon kufirin deri në të cilin Sigurveari mundëson kontraktimin e sigurimit, kontrata për sigurimin e jetës është e pavlefshme dhe Sigurveari ka për obligim të kthejë të gjitha shumat e premisë së pranuar
 - b. nëse Personi i Sigurvearit ka më shumë vjet nga ajo se çka ka deklaruar, e moshja e vërtetë e tij nuk e kalon kufirin deri në të cilin Sigurveari mundëson kontraktimin e sigurimit të jetës, kontrata është e plotfuqishme, ndërsa shuma e sigurvearit zvogëlohet në proporcion me preminë e paraparë për sigurimin e jetës për moshën e saktë të Personit të Sigurvearit
 - c. nëse Personi i Sigurvearit ka më pak vjet (moshë) se ajo që është deklaruar me rastin e kontraktimit të sigurimit, shuma e

sigurvearit rritet në harmonizim me preminë që do të duhet të paguhej bazuar në moshën e saktë të Personit të Sigurvearit.

Neni 11 - Kufizimi i Përgjegjësive të Sigurvearit

1. Përgjegjësitë e Sigurvearit kufizohen në shumën e barabartë me rezervën matematikore të mbledhur nëse vdekja e Personit të Sigurvearit rezulton nga:
 - a. lufta
 - b. çfarëdo akti i cili në vete përmban karakteristika të terrorizmit
 - c. katastrofa nukleare
 - d. pjesëmarrja në konflikte të armatosura, luftë qytetare, çrregullime, kryengritje apo trazira në anën e nxitësit të trazirave
 - e. kryen veprimtari në cilësi të pilotit ushtarak, pilotit të helikopterit apo pilotit special (p.sh. fluturues me fluturake me/pa motor, drejtues balloni, kërcyes me parashutë)
 - f. marrja me sporte ekstreme (p.sh. alpinizëm, zhytje dhe të ngjashme)
 - g. pjesëmarrja në gara në vozitje apo trajnime në automjetet për drejtim në tokë, ajër apo ujë
2. Si përjashtim nga udhëzimet nga paragrafët e., f., g., e pikës 1. të këtij neni, Sigurveari kompenzon shumën e plotë të sigurvearit nëse në policë është kalkuluar dhe evidentuar premia shtesë për sigurim nga rreziqet e veçanta.

Neni 12 - Përjashtimet nga Përgjegjësitë e Sigurvearit

1. Të përjashtuara janë të gjitha përgjegjësitë e Sigurvearit nëse aksidenti ka ndodhur si pasojë e rrethanave në vazhdim:
 - a. për shkak të tërmetit
 - b. gjatë drejtimit të automjeteve për vozitje në tokë, ajër apo ujë pa leje zyrtare, e cila i jep autorizim drejtimi me atë lloj dhe markë të automjetit. Konsiderohet se Personi i Sigurvearit posedon leje zyrtare kur gjatë përgatitjes së provimit merr drejtimin me mbikëqyrje të personit zyrtar profesional
 - c. nëse Kontraktuesi i Sigurvearit, Personi i Sigurvearit apo Përfituesi i sigurimit me qëllim ka shkaktuar aksidentin me rastin e përgatitjes, tentimit apo kryerjes së veprës penale me paramendim, dhe me rastin e ikjes pas aktit të tillë

- d. nëse dëshmohet ndikimi i narkotikëve apo gjendjes së dehjes së Personit të Siguruar. Konsiderohet se Personi i Siguruar është në gjendje të dehur nëse konstatohet prania e alkoolit në gjak më shumë se 10,8 mil. mol (0.50 promil) tek drejtuesi, dhe tek të siguruarit tjerë më shumë se 21.6 mil. mol (1.00 promil)
2. Kontrata për sigurim konsiderohet e pavlefshme nëse në momentin e kontraktimit ka ndodhur rasti i siguruar apo ka qenë duke ndodhur ose ka qenë e sigurt se do të ndodhë ose nëse atëherë ka pushuar mundësia që ajo të ndodhë. Në këto raste premia e paguar nuk i kthehet Kontraktuesit.

Neni 13 - Vetëvrasja e të Siguruarit

1. Vetëvrasja nuk mbulohet me kontratën për sigurim e jetës, nëse ndodh në dy vitet e para të sigurimit. Pas vitit të dytë të sigurimit plotësisht mbulohet me sigurim.

Neni 14 - Përfituesi i Sigurimit

1. Kontraktuesi i Sigurimit të Jetës mundet që në kontratë apo më vonë me mjete juridike, por edhe me testament të caktojë Përfituesin e policës.
2. Nëse sigurimi ka të bëjë me jetën e ndonjë personi të dytë, për caktimin e Përfituesit nevojitet pëlqimi me shkrim nga ai.
3. Përfituesi nuk duhet të caktohet me emër domosdoshmërisht. Mjafton që shënimet për caktimin e tij të janë të mbajtura. Kur për përfitues janë të caktuar fëmijët apo trashëgimtarët, përfitimi ju takon edhe atyre të lindur më vonë, deri sa përfitimi i cili i takon bashkëshortit/es i jepet personit i/e cila ka qenë në martesë me të siguruarin në momentin e vdekjes së tij/saj.
4. Nëse Përfituesi është person i moshës jomadhore, shuma e siguruar do ti paguhet prindit të tij, respektivisht kujdestarit.
5. Shuma e siguruar e cila duhet ti paguhet Përfituesit nuk hyn në trashëgiminë e të siguruarit gjithashtu as në rastin kur për përfitues janë caktuar pasardhësit.

Neni 15 - Raportimi i Rastit të Siguruar

1. Personi që kërkon kompensim në bazë të sigurimit të jetës obligohet që Siguruesit ti dorëzojë kërkesën menjëherë pas ndodhjes së rastit të siguruar.

2. Krahas me kërkesë duhet të paraqitet edhe dokumentacioni në vazhdim:
 - a. policia e sigurimit të jetës
 - b. dëshmia për datëlindjen e të siguruarit
 - c. certifikata nga libri amëz i të vdekurve, nëse kemi të bëjmë me vdekje të Personit të Siguruar
 - d. siguruesi ka të drejtë që si dokumentacion shtesë të kërkojë dëshmitë mjekësore, zyrtare dhe të tjera, të nevojshme për verifikimin e rastit të siguruar dhe lartësisë së kompensimit sipas bazës për sigurim

Neni 16 - Kompensimi i Shumës së Siguruar

1. Kur ndodh rasti i siguruar, Siguruesi është i obliguar që të paguaj një pjesë apo shumën e plotë të siguruar të përcaktuar me kontratë në afat prej katërmëdhjetë ditësh, duke llogaritur ditën kur Siguruesi ka pranuar njoftimin, respektivisht kërkesën komplete që ka ndodhur rasti i siguruar.
2. Nëse për vërtetimin e ekzistimit të obligimeve të Siguruesit apo shumës nevojitet kohë, ky afat fillon të rrjedhë nga dita kur është vërtetuar ekzistimi i obligimit dhe shumës përkatëse, respektivisht nga dita kur Siguruesit i ka mbërritur dokumenti dëshmi i fundit.
3. Kur Siguruesi paguan shumën e sigurimit personit i cili do të kishte të drejtë në të, dhe Kontraktuesi i Sigurimit nuk e ka caktuar Përfituesin, ai lirohet nga obligimet nga kontrata nëse në momentin e realizimit të pagesës nuk e ka pasur të njohur, as që ka mundur ta dijë se Përfituesi është caktuar me testament apo me ndonjë akt tjetër, i cili nuk i është dorëzuar, dhe sipas kësaj Përfituesi ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës së sigurimit nga personi i cili e ka pranuar atë. Njëjtë vlen edhe tek ndërrimi i Përfituesit.

Neni 17 - Akumulimi i Kompensimit dhe Shumës së Siguruar

1. Në sigurimin e jetës Siguruesi i cili e ka paguar shumën e siguruar nuk mundet sipas asnjë baze juridike të ketë të drejtë në kompensim nga pala e tretë përgjegjëse për ndodhjen e rastit të siguruar.

Neni 18 - Dhënia në Dispozicion e Policës

1. Kontraktuesi i Sigurimit ka të drejtën e dhënies në dispozicion të policës.
2. Dhënia e policës në dispozicion është e plotfuqishme nëse Siguruesi ka marrë

njoftimin me shkrim, dhe është kompletuar dokumentacioni përkatës.

3. Kontraktuesi i Sigurimit të cilit në bazë të vënies në dispozicion të policës së sigurimit të jetës i është aprovuar kredia, nuk ka të drejtë në kompensim të shumës së siguruar, respektivisht në riblerjen e sigurimit, nëse plotësisht nuk i ka përmbushur obligimet e tij, kur e ka arritur të drejtën në kompensim.

Neni 19 - Deklaratat në Lidhje me Kontratën e Sigurimit

1. Gjatë periudhës së kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit, të gjitha deklaratat të cilat kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit, Kontraktuesi i Sigurimit ka për obligim të ia dorëzojë Siguruesit në formatin e shkruar në adresën e selisë të Siguruesit.
2. Në rast të ndërrimit të adresës, Kontraktuesi i Sigurimit e ka për obligim ta njoftojë Siguruesin dhe të ia dorëzojë adresën e re. Në të kundërtën të gjitha informatat e Siguruesit do të dorëzohen në adresën e fundit të njohur.
3. Në rast të ndërrimit të vendbanimit jashtë vendit, Kontraktuesi i Sigurimit e ka për obligim ta emërojë personin në vendin tonë i cili do të jetë i autorizuar për praninë të informatave.
4. Siguruesi e ka për obligim që të gjitha informatat të ia dorëzojë Kontraktuesit në adresën e Kontraktuesit në formë të shkruar.
5. Të gjitha ndryshimet në policë mund të zbatohen vetëm me miratimin e Kontraktuesit të sigurimit.

Neni 20 - Pjesëmarrja në Fitim

1. Personi i Siguruar, respektivisht Përfituesi i sigurimit, merr pjesë në një pjesë të fitimit të realizuar bazuar në investimin e mjeteve të sigurimit të jetës. Pjesëmarrja në fitim shërben për rritjen e shumës së kontraktuar të sigurimit.
2. E drejta e pjesëmarrjes në fitim realizohet vetëm për sigurimet për të cilat vlen obligimi i kontraktuar i Siguruesit në rast të mbijetimit.
3. Lartësia dhe mënyra e ndarjes së fitimit të realizuar e cila i takon Personit të Siguruar, respektivisht Përfituesit, caktohet me vendim të organit përgjegjës për të cilën i jepet informata Kontraktuesit.
4. E drejta e pjesëmarrjes në fitim arrihet me ndodhjen e rastit të siguruar dhe kryhet së bashku me pagesën e shumës së siguruar,

respektivisht vlerës së riblerjes nëse polica gjatë kohëzgjatjes së sigurimit është ri blerë.

5. Fitimi nuk ju ndahet policave nga pika 2. e këtij neni, nëse nuk kanë kaluar së paku dy vite nga fillimi i sigurimit për sigurimet me kohëzgjatje të kontraktuar deri në 15 vite, respektivisht 3 vite për sigurimet me kohë zgjatje të kontraktuar për 15 apo më shumë vite.
6. Pavarësisht nga pika 5. e këtij neni, fitimi që nga viti i parë e tutje i përshkruhet policave me premi të përnjëhershëm.
7. Pavarësisht nga këto kushte fitimi nuk ju takon policave ku rezerva mesatare matematikore për një vit kur llogaritet fitimi nuk ka qenë më e madhe se 0.
8. Policave të riblera, nuk ju takon fitimi i llogaritur për atë vit kur është riblerë polica.

Neni 21 - Shkëputja e Kontratës dhe Riblerja e Policës

1. Kontraktuesi i Sigurimit ka të drejtë të kërkojë shkëputjen e kontratës për sigurim. Kërkesa me shkrim duhet të dorëzohet së paku 30 ditë para arritjes së premisë.
2. Nëse Kontraktuesi kërkon shkëputje të kontratës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të dërgesës me të cilën i dorëzohen kushtet dhe polica e sigurimit, shuma e paguar e premisë kthehet dhe kontrata ndërpritet.
3. Nëse kërkesa për shkëputje të kontratës është kërkuar pas 30 ditëve të pranimi të dërgesës me të cilën i dorëzohen kushtet dhe polica e sigurimit, Siguruesi e ka për obligim që ta paguaj vlerën riblerëse të policës.
4. Të drejtë në riblerje të policës nuk ka Përfituesi.
5. Riblerja e policës mund të kërkohet nga personi të cilit polica ju ka dhënë në disponim, nëse kjo është shënuar në policë, dhe kërkesat për të cilën arsye polica është dhënë në dispozicion të mos jetë e kompletuar.
6. Tek riblerja, obligimet e Siguruesit përfundojnë në ora 00.00 në ditën kur shuma e riblerjes është paguar.
7. Baza për vlerën e riblerjes është rezerva matematikore për nevojat e pagesës në rast të mbijetimit, e zvogëluar për shpenzimet e blerjes dhe për të gjitha premitë e papaguara deri në datën e riblerjes. Nëse polica nuk ofron asnjë lloj pagese në rast të mbijetesës, ajo policë ndërpritet pa të drejtë në pagesën e shumës së riblerjes.

Neni 22 - Ndërrimi i Kushteve dhe Tarifës së Sigurimit

1. Kushtet dhe tarifat mundën që gjatë periudhës së kohëzgjatjes së sigurimit të ndërrohen vetëm me miratim me shkrim nga ana e Kontraktuesit të Sigurimit.

Neni 23 - Duplikati i Policës

1. Policën e humbur Siguruesi e ndërron kur i dërgohet vendim i plotfuqishëm që origjinali i policës për sigurimin e jetës është humbur dhe ajo është cilësuar jo-valide.
2. Siguruesi mund ta caktojë që polica e humbur deri në shumën e caktuar të sigurimit të ndërrohet me duplikatin edhe pa vendim gjyqësorë mbi humbjen.

Neni 24 - Kompensimi për Shërbime

1. Kontraktuesi i Sigurimit obligohet të paguaj kompensimin për kryerjen e të gjitha shërbimeve të cilat veçanërisht i kërkon nga Siguruesi, dhe Siguruesi ta kërkojë këtë në lartësinë e përcaktuar nga organi kompetent i Siguruesit
2. Kontraktuesi i Sigurimit obligohet që krahas premisë së kontraktuar të paguaj të gjitha tatimet të cilat parashihen në bazë të rregulloreve adekuate.

Neni 25 - Vjetërsimi

1. Kërkesat nga kontrata për sigurimin e jetës vjetërsohen sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve .

Neni 26 - Kompetencat në Rast të Mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet në mes të Siguruesit dhe të siguruarit respektivisht të siguruarit në një të anë dhe kompanisë në anën tjetër i zgjedh gjykata kompetente në Prishtinë.